



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivered	05-05-2023	3	Viti god Year
Organ /Mësia Organi /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojç Prilog Appendix	Sasia Koliciteta Quantity
KPMSHCK	4060/2023		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. Nr. 413/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtar Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 413/2023, të datës 24.02.2023, të ankuesit \_\_\_\_\_ me adresë banimi rruga \_\_\_\_\_, Nr. \_\_\_\_\_ Hyrje nr. \_\_\_\_\_ nga Komuna e Prishtinës kundër organit të punësimit Agjencia e Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.05.2023 mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr. 413/2023 të datës 24.02.2023 të parashtruar nga ankuesit \_\_\_\_\_.
- II. Ankuesi udhëzohet të dërgoj lëndën për shqyrtim dhe vendosje Gjykatës Kompetente për realizimin e të drejtës së tij.

A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ me datë 24.02.2023, me numër protokolli 2046/2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kompensimin e pagave nga koeficientit tetë (8) në koeficiente dhjetë (10), nga data 02.02.2009, deri me datë 24.12.2022, deri në arritjen e moshës së pensionimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.02.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese të Agjencia e Statistikave të Kosovës. Ndërsa me datë 07.03.2023, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 36/2023, e datës 24.02.2023, A.Nr.413/2023 me numër protokolli 2046/2023 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 19.12.2022, për përfundimin e marrëdhënies së punës; kontrata e marrëdhënies së punës e datës 29.09.2004; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 02.02.2009; Aktgjykimi C1 nr. 502/2007, i Gjykatës Komunale në Prishtinë; Aktvendimi i datës 08.05.2013, i Gjykatës së Apelit të Kosovës; Aktgjykimi C nr.1558 /2012 i Gjykatë Themelore në Prishtinë; Akt Emërim i datës 04.04.2012; Aktvendimi 04.10.2006, për ndërprerjen e marrëdhënies së Punës; Njoftimi i datës 12.04.2009; Kërkesë e datës 22.02.209, për Zbatimin të Ligjshmërisë; Përgjigje në Ankesë e datës 07.03.2023, me numër protokolli 2441/2023, e datës 07.03.2023.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i provave të lëndës ka gjetur se ankuesi \_\_\_\_\_, me datë 19.12.2022, me Vendimin nr. protokolli 01-03-943, është njoftuar për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit në bazë të neni 60 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Me dispozitat e Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht me nenin 60 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, si dhe neni 2 është përcaktuar se: " 1. *Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon për shkak të ligjit, kur: 1.3. plotësohet moshja për pensionim;*" rrjedhimisht, në kuptim të kësaj dispozite ligjore si dhe duke u bazuar në vendimin me numër protokolli 01-03-943, të datës 19.12.2022, ankuesit i ka përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, prandaj duke u nisur nga kjo gjendje faktike dhe ligjore, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit civil as të kandidatit për pranimin në shërbimin civil të Kosovës.

Andaj në bazë të nenit 16, paragrafi 1 Ligji nr. 06/1 -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: " 1. *Nëpunësi civil, apo kandidati për pranim në shërbimin civil i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshill, lidhur me pretendimin për shkeljen e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës; 2. Moshja e pensionimit rregullohet me Ligjin e punës* prandaj Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, andaj pas konstatimit se ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit civil, apo të kandidatit për pranimin në shërbimin civil të Kosovës.

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr. 413/2023 të datës 24.02.2023, dhe meqenëse nga shkresat e lendes del se ankuesit i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, Kolegji duke u bazuar në nenin 79, të Ligji nr. 03/1-212 të Punës vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamentit për Çështje Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda A.nr. 413/2023**

*Rushit KAJTAZI*

*Procesmbajtës*

*Eshref SHABANI*

*Kryetar i Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

Ankuesit .

Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Statistikave të Kosovës;

Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës;

Arkivit të KPMSHCK-së